



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Shtator 2021

Nr: 442

VE N D I M

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË,  
KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË  
SHQIPËRISË, QARKU FIER, ZJ. MIRELA LLAMBRO PITUSHI**

Në mbështetje të neneve 19 pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7 dhe 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ

Me shkresën nr. 1855/1 prot., datë 10.09.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes, të z. Gramoz Kaso Ruçi, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore, qarku Fier, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.02.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.04.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 417, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese, në zonën zgjedhore qarku Fier për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste e Shqipërisë për zonën zgjedhore qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04. 2021, ka fituar 09 (nëntë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista



shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Fier, janë:

numri rendor 01 (një) z. Erion Mirdash Braçe, numri rendor 02 (dy) z. Petro Vasil Koçi, numri rendor 03 (tre) zj. Lindita Izet Buxheli, numri rendor 04 (katër) z. Baftjar Mehmet Zeqaj, numri rendor 05 (pesë) zj. Antoneta Nasi Dhima, numri rendor 06 (gjashtë) z Bujar Avdulla Çela., numri rendor 07 (shtatë) zj. Tatiana Nuredin Piro, numri rendor 08 (tetë) z. Gramoz Kaso Ruçi,

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Fier, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 163 pika 7 dhe nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 417, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutuar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 10, (dhjetë) zj. Mirela Llambro Pitushi.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, zj. Mirela Llambro Pitushi, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 1824 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Fier, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Mirela Llambro Pitushi, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Gramoz Kaso Ruçi, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore, qarku Fier, i renditur me numër rendor 10, (dhjetë) zj. Mirela Llambro Pitushi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”



## **V E N D O S:**

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore qarku Fier, zj. Mirela Llambro Pitushi.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

